



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

PLANI I PUNËS JANAR - DHJETOR 2022

JANAR, 2022

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| I. AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ASCAP) | 4 |
| 1.1. Misioni i ASCAP-it..... | 4 |
| 1.2. Objektivat e përgjithshëm të ASCAP-it, Janar – Dhjetor 2022 | 5 |
| 1.3. Sfidat e ASCAP-it..... | 6 |
| II. DREJTORIA E KURRIKULËS DHE E KUALIFIKIMIT | 6 |
| 2.1. Gjendja aktuale | 6 |
| 2.1.1 Kurrikula | 6 |
| 2.1.2 Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë | 7 |
| 2.2. Vizioni i DKK-së | 7 |
| 2.3. Misioni i DKK-së..... | 8 |
| 2.4. Vlerat drejtuese të DKK-së..... | 8 |
| 2.5. Detyrat kryesore të DKK-së..... | 8 |
| 2.6. Objektivat e përgjithshëm të DKK-së..... | 9 |
| 2.7. Objektivat e detajuar të DKK-së..... | 10 |
| 2.8. Plani i veprimtarive për DKK-në | 12 |
| III. DREJTORIA E PERFORMANCËS..... | 33 |

| | |
|--|-----------|
| Hyrje..... | 33 |
| 3.1. Vizioni..... | 34 |
| 3.2. Qëllimi..... | 34 |
| 3.3. Vlerësimi i sistemit..... | 35 |
| Vlerësimet nga programet/politikat specifike..... | 36 |
| 3.5. Objektivat e përgjithshëm të Drejtorisë së Performancës | 37 |
| Tabela e veprimtarive të planifikuara, Janar-Dhjetor 2022..... | 40 |
| IV. DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË..... | 49 |
| 4.1 Gjendja aktuale..... | 49 |
| 4.1.1 Vlerësimi i cilësisë së kurrikulës | 50 |
| 4.1.2 Organizimi dhe drejtimi i institucioneve arsimore | 50 |
| 4.2 Vizioni..... | 50 |
| 4.3 Misioni | 51 |
| 4.4 Vlerat drejtuese | 51 |
| 4.5 Detyrat kryesore të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë | 51 |
| 4.6 Objektivat e përgjithshëm për periudhën janar-dhjetor 2022..... | 53 |
| 4.7 Objektivat e detajuara të DVC-së për periudhën janar-dhjetor 2022..... | 53 |
| 4.8 Tabela e veprimtarive të Drejtorisë së Vlerësimit të Cilësisë | 54 |

I. AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (ASCAP)

1.1.Misioni i ASCAP-it

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). Misioni i ASCAP-it është të garantojë performancën e sistemit të arsimit parauniversitar dhe cilësinë e arsimit parauniversitar publik e privat në përputhje me qasjen e kurrikulës së bazuar në zhvillimin e kompetencave.

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) kryen detyrat, si më poshtë vijon:

- a) vlerëson performancën e sistemit arsimor parauniversitar, efektshmërinë dhe eficiencën e masave si dhe përmbushjen e objektivave;
- b) vlerëson mënyrën e organizimit e të funksionimit të sistemit arsimor parauniversitar dhe merr masat e nevojshme në rast mbivendosjeje funksionesh apo mungese ekzekutimi të detyrave funksionale nga institucionet përgjegjëse;
- c) vlerëson si ndërliiden, koordinohen apo ndërveprojnë institucionet e sistemit arsimor parauniversitar me njëri-tjetrin, duke garantuar nivelin e duhur të integritimit për sigurimin e arsimit parauniversitar cilësor;
- d) kryen analiza të ndryshme mbi bazën qendrore e të integruar të të dhënave të sistemit të arsimit parauniversitar dhe shpërndan informacionin;
- e) harton dhe i propozon ministrit për miratim standarde, protokolle, rregulla për ofrimin e shërbimeve arsimore si dhe vlerëson impaktin e tyre në këto shërbime;
- f) analizon, zhvillon e rishikon dokumentet si: korniza kurrikulare, programet lëndore dhe standardet, sipas fushave kurrikulare;
- g) harton dhe boton dokumentet kurrikulare për arsimin parauniversitar si dhe materiale mbështetëse për zbatimin e kurrikulës, në nivel kombëtar;
- h) harton, analizon dhe rishikon standardet e zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare;
- i) vlerëson nevojat për zhvillim profesional, programet kombëtare dhe materialet mbështetëse për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;

- j) organizon zhvillimin profesional dhe menaxhon procesin e kualifikimit të punonjësve arsimorë në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit parauniversitar, publik dhe privat;
- k) realizon punë kërkimore-studimore, analiza periodike dhe u ofron ekspertizë strukturave politike e vendimmarrëse për politikat arsimore dhe reformat në fushën e arsimit parauniversitar;
- l) ofron këshillim për institucionet arsimore parauniversitare të të gjitha niveleve në fushat e përmbajtjes kurrikulare, të didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie, si dhe në drejtimin e menaxhimit të shkollës dhe arsimit në tërësi;
- m) vlerëson, mbi bazë risku, veprimtarinë e institucionit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të arsimit parauniversitar dhe të institucioneve arsimore publike e private të sistemit të arsimit parauniversitar, për respektimin në vazhdimësi të kushteve dhe detyrimeve për ofrimin e shërbimit cilësor, shoqëruar me lënien e detyrave/sugjerimeve/rekomandimeve për përmirësimin e elementeve të caktuara të institucioneve apo gjithë sistemit të arsimit parauniversitar si: kurrikul, standarde dhe metodologji;
- n) nënshkruan marrëveshje dhe bashkëpunon me institucione të arsimit të lartë, institucione të tjera apo me organizata kombëtare dhe/ose ndërkombëtare për veprimtari apo aktivitete që lidhen me misionin e saj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

1.2.Objektivat e përgjithshëm të ASCAP-it, Janar – Dhjetor 2022

Gjatë vitit 2022, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar ka këta objektiva të përgjithshëm:

1. Kurrikul me standarde europiane dhe më gjerë për zhvillimin e kompetencave të të nxënësve gjatë gjithë jetës, përfshirë zhvillimin e kompetencës digjitale.
2. Zhvillimi profesional i drejtuesve dhe mësuesve për të përmirësuar cilësinë e procesit të mësimdhënies-nxënies.
3. Nxitja e arsimit gjithëpërfshirës dhe sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve në sistemin e arsimit parauniversitar.
4. Krijimi i kornizës së treguesve dhe mbledhja e të dhënave në funksion të vlerësimit të performancës së sistemit arsimor parauniversitar, publik dhe privat.

5. Garantimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar publik dhe privat.
6. Hartimi i Kornizës për Vlerësimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare.
7. Hartimi i treguesve për vlerësimin e cilësisë së organizimit dhe drejtimit të Institucioneve Arsimore Parauniversitare.

1.3.Sfidat e ASCAP-it

Për të realizuar objektivat, ASCAP-i përballlet me këto sfida:

- Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë për arsimim duhet të bazohet në kompetencat e të nxënësve gjatë gjithë jetës.
- Bashkëpunimi me fakultetet e mësuesisë dhe partnerë të tjerë lokalë dhe ndërkombëtarë për përgatitjen e mësuesve në përputhje me kurrikulën e zbatuar në arsimin parauniversitar.
- Komunikimi i vazhdueshëm me institucione në varësi të MAS-it për mbledhjen e raporteve dhe materialeve që lidhen me vlerësimin e performancës së sistemit të arsimit parauniversitar.
- Zhvillimi profesional i stafeve të DRAP/ZVAP-ve për inspektimin dhe monitorimin e institucioneve arsimore me qëllim përmirësimin e sistemit të APU-së.

II. DREJTORIA E KURRIKULËS DHE E KUALIFIKIMIT

2.1.Gjendja aktuale

2.1.1 Kurrikula

Kurrikula bazuar në kompetenca u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe vlerave të të gjitha grupeve të nxënësve, pavarësisht nga prejardhja ose veçoritë e tyre. Ajo i krijon mundësi të barabarta për sukses secilit nxënës. Ndryshimi kryesor në fushën e arsimit lidhet me të nxënësve, i cili përkufizohet si një proces aktiv mendor që ndodh kur mësuesi zgjedh metodën ose stilin e duhur të të nxënësve duke u bazuar në nevojat e nxënësve, në vend që thjesht të transferojë informacion dhe të kërkojë memorizimin e tij nga nxënësit. Për këtë arsye, institucionet arsimore kanë filluar të kërkojnë metoda më cilësore të mësimdhënies që synojnë të krijojnë nxënës aktivë

dhe kritikë. Një nga mënyrat përmes të cilës mësuesit mund ta realizojnë këtë qëllim, është kombinimi i mësimdhënies në klasë me mësimin digjital brenda dhe jashtë klasës. Studimet dëshmojnë se ka një sërë strategjish të të nxënësve konstruktivist që lidhin teknologjinë me të mësuarit, pasi kështu mundësohet bashkëpunimi dhe ndërveprimi social përmes të cilëve nxënësit ndërtojnë njohuritë e tyre. Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK-ut) në procesin mësimor është një domosdoshmëri. Ky përdorim shërben për zhvillimin e aftësive digjitale të nxënësve, të cilat garantojnë akses në botën e madhe të informacionit, integrim në jetën shoqërore dhe sukses në tregun e punës. Kësaj domosdoshmërie iu bashkëlidh edhe situata e krijuar nga pandemia COVID-19, gjatë së cilës procesi mësimor u realizua kryesisht nëpërmjet përdorimit të teknologjisë.

2.1.2 Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë

Zhvillimi profesional i punonjësve arsimorë, konsiderohet si një prioritet i arsimit për të përmirësuar dhe rritur kompetencat profesionale të mësuesit në përshtatje me reformat arsimore, si dhe rritjen e cilësisë së individit për t'u përsosur profesionalisht. Prioritet kryesor është tërheqja dhe mbajtja në punë e mësuesve cilësorë duke i motivuar ata me skema trajnimit dhe kualifikimit, të cilat bazohen në rezultate dhe jo thjesht në vitet e punës. Mësuesit novatorë kanë krijuar gjithnjë metoda të reja të mësimdhënies dhe nxënies duke kombinuar elemente të mësimdhënies tipike në klasë me mësimin e mundësuar nga teknologjia. Kompjuterët u bënë pjesë e jetës së përditshme në fillim të viteve 2000, por arsimit u tregua më i ngadalshëm në integrimin e teknologjisë kompjuterike. Përmes zhvillimeve të reja mësuesit do të integrojnë teknologjinë në procesin mësimor, duke realizuar detyra dhe duke kryer vlerësime online për t'ju ofruar nxënësve metoda, mundësi dhe hapësira të reja për të nxënë.

2.2. Vizioni i DKK-së

Vizioni i DKK-së është të hartojë kurrikul që zhvillon te nxënësit kompetencat e të nxënësve gjatë gjithë jetës si dhe të fuqizojë zhvillimin profesional të mësuesve për zbatimin e kurrikulës, duke mbështetur, inkurajuar dhe motivuar mësuesit për të rritur standardet profesionale, për të krijuar një klimë që lehtëson mësimdhënien – nxënien duke i bërë nxënësit të jenë efektiv e të suksesshëm në të nxënë.

2.3.Misioni i DKK-së

Misioni i DKK-së është që nëpërmjet punës kërkimore dhe hartimit në fushën e kurrikulës, si dhe zhvillimit profesional të mësuesve, të përmirësojë punën e mësuesve dhe stafeve drejtuese përmes përvojave të përshtatshme të mësimdhënies dhe nxënies, mbështetjes profesionale, gjithëpërfshirjes, kujdesit, frymëzimit, të cilat prevalojnë direkt në zhvillimin e kompetencave lëndore dhe kompetencave kyçe.

2.4.Vlerat drejtuese të DKK-së

DKK-ja udhëhiqet nga këto vlera drejtuese:

- Ndërmerr iniciativa dhe propozon përmirësime në politikat e fushës së kurrikulës dhe sistemit të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në shkollë.
- Mbështet dhe zhvillon profesionalisht stafet e njësive arsimore vendore dhe të institucioneve arsimore në zbatimin e politikave dhe standardeve bashkëkohore për përmirësimin e cilësisë në shkollë.
- Mësuesit janë bartësit kryesorë të të gjitha ndryshimeve dhe gjithçka varet nga formimi dhe motivimi i tyre.

2.5.Detyrat kryesore të DKK-së

Detyrat kryesore të Drejtorisë së Kurrikulës dhe Kualifikimit, në ASCAP janë:

- analizon, zhvillon dhe rishikon dokumentet e rëndësishme si: Korniza Kurrikulare, programet lëndore, standardet sipas fushave/lëndëve kurrikulare;
- harton dhe boton dokumentet kurrikulare për arsimin parauniversitar;
- harton programe lëndore për të gjitha ciklet (arsimi parashkollor dhe të gjitha klasat 1-12);
- harton dhe boton udhëzues kurrikularë si dhe materiale mbështetëse për zbatimin e kurrikulës në nivel kombëtar;
- harton, analizon dhe rishikon standardet e zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore parauniversitare;
- vlerëson nevojat për zhvillim profesional, programet kombëtare dhe materialet mbështetëse për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
- harton programe kombëtare orientuese për kualifikimin dhe zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar;
- organizon zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit parauniversitar;

- menaxhon dhe organizon procesin e kualifikimit të punonjësve arsimorë në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit parauniversitar;
- mbështet funksionimin e rrjeteve profesionale dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm të drejtuesve të këtyre rrjeteve nëpërmjet instrumenteve përkatëse;
- menaxhon procesin e akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
- harton instrumente për vlerësimin e cilësisë së trajnimeve të ofruara nga agjencitë që kanë akredituar programe/module trajnimi për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë;
- harton fondin e pyetjeve për testimin kombëtar “Mësues për Shqipërinë”, si domosdoshmëri për sigurimin e cilësisë së formimit të mësuesve kandidatë për ushtrimin e profesionit të mësuesit në arsimin parauniversitar;
- realizon punë kërkimore-studimore, analiza periodike dhe u ofron ekspertizë strukturave politike e vendimmarrëse për politikat arsimore dhe reformat në fushën e arsimit parauniversitar;
- ofron këshillim për institucionet arsimore parauniversitare të të gjitha niveleve, në fushat e përmbajtjes kurrikulare, didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie, si dhe për drejtimin dhe menaxhimin e shkollës dhe arsimit në tërësi;
- bashkërendon veprimtarinë e saj me drejtoritë dhe sektorët e tjerë të ASCAP-it, me ministrinë përgjegjëse për arsimin, si dhe me institucione të tjera të të gjitha niveleve brenda dhe jashtë vendit, për realizimin cilësor të detyrave të saj;
- mundëson dhe mbështet kualifikimin dhe vetëkualifikimin e stafit të drejtorisë;
- bashkëpunon me institucione të arsimit të lartë apo me organizata kombëtare dhe/ose ndërkombëtare për veprimtari apo aktivitete që lidhen me detyrat e saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2.6.Objektivat e përgjithshëm të DKK-së

DKK-ja ka këta objektiva të përgjithshëm për janar - dhjetor 2021:

1. Të hartojë dhe të rishikojë kurrikul me standarde europiane dhe më gjerë për zhvillimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës, përfshirë zhvillimin e kompetencës digjitale.
2. Të organizojë zhvillimin profesional të drejtuesve dhe mësuesve për të përmirësuar cilësinë e procesit të mësimdhënies-nxënies.

3. Të nxisë arsimin gjithëpërfshirës dhe të sigurojë mirëqenien sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve në sistemin e arsimit parauniversitar.

2.7.Objektivat e detajuar të DKK-së

DKK-ja ka këto objektiva të detajuar për janar - dhjetor 2022:

- 1.1 Të hartohet material në mbështetje të mësuesve lidhur me zhvillimin e modelit të arsimit të kombinuar dhe zbatimin e kompetencës digjitale.
- 1.2 Të hartohet një material mbështetës për mësuesit, i cili inicion njohjen e koncepteve kryesore të kodimit.
- 1.3 Të hartohet material ndihmës për mësuesit e arsimit fillor në ndihmë të zbatimit të kurrikulës me kompetenca me synim përgatitjen më të mirë të nxënësve për provimin e VANAF-it si dhe trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale të AF.
- 1.4 Të hartohet udhëzuesi dhe materiale të tjera mbështetëse për zbatimin e programit “Edukimi për zëjet dhe artet në arsimin parauniversitar”.
- 1.5 Të hartohet programi i klasës parë të TIK bazuar në planin e miratuar të arsimit bazë për përfshirjen e TIK që në klasë të parë.
- 1.6 Të hartohen programet mësimore për disiplinat sportive gjimnastikë, atletikë, tenis, sipas gjinisë/nivelit të klasës (VI-IX).
- 1.7 Të hartohen materiale mbështetëse për mësuesit për integrimin dhe trajtimin e temave ndërkurrikulare të përfshira në kurrikulën me bazë kompetencat, si çështje që mundësojnë integrimin kurrikular.
- 1.8 Të hartohen programet orientuese të provimeve kombëtare për vitin shkollor 2022-2023.
- 1.9 Të realizohet redaktimi shkencor dhe sigurimi i cilësisë së videove që publikohen në Radio Televizionin Shqiptar – Shkolla.
- 1.10 Të realizohet procesi i rishikimit të teksteve shkollore në arsimin parauniversitar.
- 1.11 Të hartohen standardet e mentorit.
- 1.12 Të hartohen kriteret e vlerësimit të performancës së mësuesit.
- 1.13 Të hartohet manuali i portofolit të kompetencave për kulturë demokratike.
- 1.14 Të hartohen materiale mbështetëse për drejtuesit e rrjeteve profesionale sipas profileve dhe lëndëve përkatëse.
- 1.15 Të koordinojë punë me Sistemin e Menaxhimit të Institucioneve parauniversitare (SMIP).

- 1.16 Të hartohen materiale mbështetëse për vullnetarizmin dhe angazhimin vullnetar të nxënësve për mjedisin në institucionet e arsimit parauniversitar.
- 1.17 Të hartohet paketa e dokumenteve për unifikimin e Abetares në Shqipëri dhe Kosovë në bashkëpunim me MAS dhe MASHT.

- 2.1 Të organizohet procesi i kualifikimit të mësuesve 2022.
- 2.2 Të koordinohet puna e KAPT-it për akreditimin e moduleve të trajnimit.
- 2.3 Të mbështesë testimin e informatizuar "Mësues për Shqipërinë" nëpërmjet hartimit të fondit të pyetjeve dhe pjesëmarrjes në komisionet e provimeve.
- 2.4 Të zhvillojë kapacitetet e mësuesve të gjuhës angleze për zbatimin e programeve në klasë të parë dhe të dytë si dhe lidhur me materiale mbështetëse për zbatimin e këtyre programeve për zhvillimin e gjuhës angleze që nga klasa e parë e arsimit bazë.
- 2.5 Të ngrihen kapacitetet e mësuesve të gjuhës së huaj lidhur me materiale ndihmëse për mësuesit e gjuhës së huaj për përdorimin e teknologjive të mësimdhënies.
- 2.6 Të ngrihen kapacitetet e koordinatorëve të DRAP-ve, të ZVAP-ve, të shkollave dhe mësuesve që zbatojnë edukimin për artet dhe zejet në shkollë.
- 2.7 Të zhvillojë kapacitetet e mësuesve të TIK lidhur me zbatimin e programeve në klasë të parë.
- 2.8 Të ngrihen kapacitetet e mësuesve për programin “Edukimi për median dhe informimin”.
- 2.9 Të fuqizojnë rrjetet profesionale të mësuesve të klasave kolektive.
- 2.10 Të mbështesë drejtuesit e rrjeteve profesionale dhe drejtuesit e kopshteve në arsimin parashkollor lidhur me zbatimin e dokumenteve kurrikulare dhe standardeve profesionale të drejtuesve të institucioneve të arsimit parashkollor.
- 2.11 Të mbështesë drejtuesit e rrjeteve profesionale në arsimin fillor për përdorimin e TIK në mësimdhënie – nxënie.
- 2.12 Të monitorohen mësuesit e certifikuar për zbatimin e programit të edukimit shëndetësor seksual.

- 2.13 Të mbështesë e rrjeteve profesionale dhe në veçanti rrjeteve profesionale të gjuhës shqipe, matematikës dhe shkencave, në përputhje me aftësitë që kërkohen në testet ndërkombëtare.
- 2.14 Të mbështeten drejtuesit e rrjeteve profesionale të shkencave shoqërore lidhur me mënyrën se si të trajtojnë në klasë çështje që kanë të bëjnë me antisemitizmin, Holokaustin, gjenocidin, dhunën, diskriminimin apo çfarëdolloj forme tjetër të shkeljes së të drejtave të njeriut.
- 2.15 Të organizojë të gjitha veprimtaritë e TALIS 2024.
- 2.16 Të koordinojë dhe të organizojë procesin e regjistrimit të mësuesve të gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë.
- 2.17 Të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve arsimore për menaxhimin e emergjencave.
- 3.1 Fuqizimi i rrjeteve profesionale të mësuesve në ndihmës në institucionet e arsimit parauniversitar.
- 3.2 Trajnimi i mësuesve ndihmës që punojnë me nxënës me aftësi të ndryshe dhe me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë.
- 3.3 Të ngrihen kapacitetet e punonjësve të shërbimit psiko-social dhe oficerëve të sigurisë lidhur me veçoritë e moshës dhe të fuqizohen rrjetet profesionale të punonjësve të shërbimit psiko - social.
- 3.4 Të organizojë seminarin e përvitshëm mbi programin e integruar të mësimin shqip në diasporë.
- 3.5 Të realizohen redaktimet letrare të materialeve të hartuara nga ASCAP.
- 3.6 Të realizohet Revista Pedagogjike, ASCAP 2022.
- 3.7 Të bashkëpunojë me institucionet qendrore, njësitë arsimore vendore, me specialistë të sigurimit të cilësisë dhe me partnerë të tjerë lokalë dhe ndërkombëtarë, për zbatimin e dokumenteve kurrikulare me kompetenca si dhe për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë, për ta zhvilluar shkollën gjithnjë e më shumë në një shkollë në shërbim të komunitetit.

2.8. Plani i veprimtarive për DKK-në

DREJTORIA E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMI

| Nr. | Objektiva | Nr. | Tregues | Përshkrimi i treguesit | Produkt | Frekuenca dhe mënyra e matjes | Personi përgjegjës |
|---|---|-------|---|--|------------------------------------|-------------------------------|---------------------------------------|
| Objektivi i përgjithshëm 1: Kurrikul me standarde europiane dhe më gjerë për zhvillimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës | | | | | | | |
| 1.1 | Të hartohet material në mbështetje të mësuesve lidhur me zhvillimin e modelit të arsimit të kombinuar dhe zbatimin e kompetencës digjitale. | 1.1.1 | Shqyrtimi i materialeve ndërkombëtare lidhur me zbatimin e arsimit të kombinuar. | Përvoja nga vende të tjera europiane dhe më gjerë lidhur me zbatimin e arsimit të kombinuar, udhëzues, studimet etj. | Materialet e studiuara. | 6-mujore | Dorina Rapti dhe grupi i punës |
| | | 1.1.2 | Hartimi i një udhëzuesi për arsimin e kombinuar. | Informimi i mësuesve dhe drejtuesve të shkollave rreth qasjes më bashkëkohore të organizimit të procesit mësimor në shekullin XXI. | Udhëzuesi i hartuar dhe publikuar. | Vjetore | |
| 1.2 | Të hartohet një material mbështetës për mësuesit, i cili iniciacionin njohjen e koncepteve | 1.2.1 | Shqyrtimi i materialeve ndërkombëtare lidhur me zhvillimin e konceptit të kodimit në shkollë. | Përvoja nga vende të tjera europiane dhe më gjerë lidhur me zbatimin e arsimit të kombinuar, udhëzues, studimet etj. | Materialet e studiuara. | 6-mujore | Eriksen Mersinllari dhe grupi i punës |
| | | 1.2.2 | Analiza e kurrikulës së APU lidhur me kompetencën digjitale. | Analiza për zhvillimin e kompetencës digjitale në | Dokumenti i analizës. | 6-mujore | |

| | | | | | | | | |
|------------|--|-------|--|--|---|----------|---------------------------------|--|
| | kryesore të kodimit. | | | kurrikulën e arsimit parauniversitar. | | | | |
| | | 1.2.3 | Hartimi i materialit mbështetës për zhvillimin e konceptit të kodimit. | Informimi i mësuesve rreth qasjes më bashkëkohore të për zhvillimin e kodimit në mosha të hershme. | Materiali I hartuar dhe publikuar. | Vjetore | | |
| 1.3 | Të hartohet material ndihmës për mësuesit e arsimit fillor me synim përgatitjen më të mirë të nxënësve për provimin e VANAF-it . | 1.3.1 | Material mbështetës për mësuesit e arsimit fillor për përgatitjen e nxënësve në vlerësimin kombëtar të klasës pestë. | Informimi i mësuesve të AF për zbatimin sa më cilësor të kurrikulës me kompetenca në përputhje me vlerësimin kombëtar. | Materiali i hartuar dhe publikuar. | 6-mujore | Aurela Zisi | |
| | | 1.3.2 | Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale të AF lidhur me këtë material. | Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale për përgatitjen më të mirë të nxënësve për provimin e VANAF-it. | 500 drejtues rrjetesh profesionale të trajnuar. | Vjetore | | |
| 1.4 | Të hartohet udhëzuesi dhe materiale të tjera mbështetëse për | 1.4.1 | Material mbështetës për drejtuesit dhe mësuesit e institucioneve arsimore parauniversitare për zbatimin e programit “Edukimi për zejet | Informimi i drejtuesve dhe mësuesve të institucioneve të arsimit parauniversitar lidhur zbatimin sa më efektiv të programit “Edukimi për zejet | Materiali i hartuar dhe publikuar. | Vjetore | Albana Markja, Evis Mastori dhe | |

| | | | | | | | | |
|------------|--|-------|--|---|--|----------|--|--|
| | zbatimin e programit “Edukimi për zejet dhe artet në arsimin parauniversitar”. | | dhe artet në arsimin parauniversitar”. | dhe artet në arsimin parauniversitar”. | | | grupi i punës | |
| 1.5 | Të hartohet programi i klasës parë të TIK bazuar në planin e miratuar të arsimit bazë për përfshirjen e TIK që në klasë të parë. | 1.5 | Hartimi i programit të klasës së parë për lëndën TIK dhe dërgimi për miratim në MAS. | Bazuar në planin mësimor të miratuar nga MAS për arsimin bazë hartohet programi i klasës së parë për TIK. | Programi e dërguar për miratim në MAS. | 3-mujore | Eriksen Mersinllari Dhe grupi i punës | |
| 1.6 | Të hartohen programet mësimore për disiplinat sportive | 1.6.1 | Hartimi i programit të klasave 6-9 për disiplinat sportive gjimnastikë, atletikë, tenis, sipas gjinisë/nivelit të klasës dhe dërgimi për miratim në MAS. | Bazuar në planin mësimor të miratuar nga MAS për klasat sportive hartohet programi i klasave 6-9 për disiplinat sportive gjimnastikë, atletikë, | Programet e dërguara për miratim në MAS. | Vjetore | Marina Topulli dhe grupi i punës | |

| | | | | | | | | |
|------------|--|-------|---|---|--|----------|---|--|
| | gjimnastikë, atletikë, tenis, sipas gjinisë/nivelit të klasës (VI-IX). | | | tenis, sipas gjinisë/nivelit të klasës dhe dërgimi për miratim në MAS. | | | | |
| 1.7 | Të hartohet material mbështetës për mësuesit për integrimin dhe trajtimin e çështjeve ndërkurrikulare | 1.7.1 | Hartimi i materialit mbështetës për mësuesit lidhur me edukimin gjinor si çështje ndërkurrikulare. | Informimi i mësuesve lidhur me integrimin kurrikular të edukimit gjinor si çështje kroskurrikulare në kurrikulën me kompetenca. | Materiali i hartuar dhe publikuar në faqen zyrtare të ASCAP. | 9-mujore | Evis Mastori dhe grupi i punës | |
| 1.8 | Të hartojë programet orientuese të maturës shtetërore për vitin shkollor 2022-2023. | 1.8.1 | Hartimi i programeve orientuese për vitin shkollor 2022 – 2023. | Hartohen të gjitha programet orientuese për vitin shkollor 2022-2022 lidhur me provimet kombëtare. | Programet orientuese të klasave V, IX, XII. | 9-mujore | Ludmilla Stefani, specialistët lëndorë | |

| | | | | | | | |
|-------------|---|--------|--|--|---------------------------------|----------|--|
| 1.9 | Të realizohet redaktimi shkencor dhe sigurimi i cilësisë së videove që do të publikohen në Radio Televizionin Shqiptar – Shkolla. | 1.9.1 | Redaktimi shkencor dhe letrar i videove për RTSH-në . | Realizohet redaktimi shkencor dhe letrar i videove për publikimin në RTSH. | Rreth 1000 video të redaktuara. | Vjetore | Eriksen Mersinllari Erjola Merolli Aurela Zisi Rozeta Hyseni Elfrida Begaj Grupet e punës |
| 1.10 | Të realizohet procesi i rishikimit të teksteve shkollore në arsimin parauniversitar. | 1.10.1 | Redaktimi shkencor teksteve shkollore në arsimin parauniversitar klasa 1-12. | Realizohet redaktimi shkencor i të gjitha teksteve shkollore bazuar në katalogun zyrtar të teksteve për klasat 1-12. | Rreth 600 tekste të redaktuara. | 3-mujore | Erida Koleci, Ines Todhe dhe Grupet e punës |

| | | | | | | | | |
|-------------|---|--------|--|---|--|----------|---------------|--|
| 1.11 | Të hartohen standardet e mentorit. | 1.11.1 | Hartohen standardet e mentorit të institucioneve të arsimit parauniversitar. | Hartohen standardet mentorit. | Dërgohen standardet e mentorit për miratim në MAS. | 6-mujore | Astrit Dautaj | |
| 1.12 | Të hartohen kriteret e vlerësimit të performancës së mësuesit. | 1.12.1 | Hartohen kriteret e vlerësimit të performancës së mësuesit. | Hartohen kriteret e vlerësimit të performancës së mësuesit bazuar në standardet profesionale të mësuesit. | Dërgohen kriteret e vlerësimit të performancës së mësuesit për miratim në MAS. | 6-mujore | Astrit Dautaj | |
| 1.13 | Të hartohet manuali i portofolit të kompetencave për kulturë demokratike. | 1.13.1 | Hartohet manuali i portofolit të kompetencave për kulturë demokratike. | Hartohet manuali i portofolit të kompetencave për kulturë demokratike. | Materiali publikohet në faqe zyrtare të ASCAP | Vjetore | Astrit Dautaj | |

| | | | | | | | | |
|-------------|---|------------|--|--|--|---------|---|--|
| 1.14 | Të hartohen materiale mbështetëse për drejtuesit e rrjeteve profesionale sipas profileve dhe lëndëve përkatëse. | 1.14. 1 | Hartimi i materialeve mbështetëse për drejtuesit e rrjeteve profesionale sipas profileve dhe lëndëve përkatëse. | Materialet mbështetëse për drejtuesit e rrjeteve profesionale synojnë aftësimin e tyre në lidhje me planifikimin, organizimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të rrjetit profesional. | 10 materiale të hartuara dhe publikuara. | Vjetore | Erida Koleci, Ines Todhe, Evis Mastori, Aurela Zisi dhe grupi i punës | |
| 1.15 | Të koordinojë punë me Sistemin e Menaxhimit të Institucioneve parauniversitar e (SMIP). | 1.15. 1 | Koordinimi me QSHA dhe AKSHI për plotësimin e rubrikave të SMIP që lidhen me ASCAP. | Rubrikat e SMIP të plotësuara. | Rubrikat e SMIP të plotësuara. | Vjetore | Eriksen Mersinllari, Evis Mastori, Rozeta Hyseni, Miranda Kurti | |
| 1.16 | Të hartohen materiale mbështetëse për vullnetarizmin dhe angazhimin | 1.16. 1 | Analizë e situatës dhe materiale mbështetëse për vullnetarizmin dhe angazhimin vullnetar të nxënësve për mjedisin në | Analiza e situatës dhe materiale mbështetëse në lidhje me angazhimin vullnetar të nxënësve dhe nismat vullnetare në | Raport i analizës së situatës dhe materiale mbështetëse. | Vjetore | Evis Mastori dhe grupi i punës | |

| | | | | | | | | |
|--|--|--------|--|--|---|----------|--------------------------------|--|
| | vullnetar të nxënësve për mjedisin në institucionet e arsimit parauniversitar. | | institucionet arsimore parauniversitare. | institucionet e arsimit parauniversitar për çështje të ndryshme të jetës komunitare, përfshirë mjedisin. | | | | |
| 1.17 | Të hartohet paketa e dokumenteve për unifikimin e Abetares në Shqipëri dhe Kosovë në bashkëpunim me MAS dhe MASHT. | 1.17.1 | Hartimi i standardeve për tekstin e abetares së unifikuar, hartimi i programit të unifikuar, hartimi i procedurave të konkurimit si dhe materiale të tjera për zhvillimin e këtij procesi. | Hartimi i standardeve për tekstin e abetares së unifikuar, hartimi i programit të unifikuar, hartimi i procedurave të konkurimit si dhe materiale të tjera për zhvillimin e këtij procesi. | Stadardet e hartuara, programi i hartuar Procedurat e hartuara | Vjetore | Erida Koleci dhe grupi i punës | |
| Objektivi i përgjithshëm 2: Të organizojë zhvillimin profesional të drejtuesve dhe mësuesve për të përmirësuar cilësinë e procesit të mësimdhënies-nxënies. | | | | | | | | |
| 2.1 | Të organizohet procesi i | 2.1.1 | Përgatitja e databazave për kualifikimin e mësuesve 2022. | Përgatiten databaza në nivel kombëtar për kualifikimin e mësuesve 2022. | 4000 mësues të planifikuar për testim. | 3-mujore | Albana Markja, | |

| | | | | | | | |
|-----|--|-------|---|--|------------------------------------|---------|---|
| | kualifikimit të mësuesve 2022. | 2.1.2 | Përgatiten fondet dhe testet sipas profileve/lëndëve për kualifikimin e mësuesve, raporti i kualifikimit. | Hartimi i 40 fondeve dhe testeve për kualifikimin e mësuesve 2022. | 40 fonde/teste të hartuara. | Vjetore | Marina Topulli, Miranda Kurti, Erjola Merolli, dhe grupi i punës |
| 2.2 | Të koordinohet puna e KAPT-it për akreditimin e moduleve të trajnimit. | 2.2 | Koordinimi i takimeve të KAPT-it. | Koordinohet puna e Komisionit të Akreditimit të Programeve të Trajnimit. | Dokumentimi i takimeve të KAPT-it. | Vjetore | Ines Todhe Gentjana Marku Marina Topulli Eriksen Mersinllari Erjola Merolli Elisabeta Paja Rozeta Hyseni, |

| | | | | | | | | |
|------------|--|-------|--|---|---|----------|--|--|
| | | | | | | | Miranda Kurti | |
| 2.3 | Të mbështesë testimin e informatizuar "Mësues për Shqipërinë" nëpërmjet hartimit të fondit të pyetjeve pjesëmarrjes në komisionet e provimeve. | 2.3.1 | Hartimi i fondit të provimit të informatizuar "Mësues për Shqipërinë". Pjesëmarrje në komisionet e testimit "Mësues për Shqipërinë". | Hartimi i fondeve dhe Komisionet sipas profileve/lëndëve. | Të paktën 25 profile/lëndë. | 9-mujore | Albana Markja Miranda Kurti Eriola Merolli specilaistët lëndorë | |
| 2.4 | Të zhvillojë kapacitetet e mësuesve të gjuhës angleze për zbatimin e programeve në klasë të parë dhe të dytë si | 2.4.1 | Përgatitja e paketës së materialeve mbështetëse për zbatimin e programeve të klasës së parë dhe të dytë. Realizimi i trajnimeve me mësuesit e gjuhës angleze të klasës së parë dhe të dytë. | Përgatitet paketa e materialeve për trajnimin e mësuesve të gjuhës angleze të klasës së parë dhe të dytë. | Materialet e trajnimit dhe trajnimi i 600 mësuesve të gjuhës angleze për klasës e parë dhe të dytë. | Vjetore | Ludmilla Stefani dhe grupi i punës | |

| | | | | | | | |
|------------|--|-------|---|---|--|---------|------------------------------------|
| | dhe lidhur me materiale mbështetëse për zbatimin e këtyre programeve për zhvillimin e gjuhës angleze që nga klasa e parë e arsimit bazë. | | | | | | |
| 2.5 | Të ngrihen kapacitetet e mësuesve të gjuhës së huaj lidhur me materiale ndihmëse për mësuesit e gjuhës së huaj për përdorimin e teknologjisë | 2.5.1 | Hartohet materiali me modele të ndryshme të përdorimit të teknologjive të mësimit dhe aplikacioneve të ndryshme në orën e gjuhës së huaj. Trajtohen mësuesit e gjuhëve të huaja për përdorimin e TIK në mësimit - nxënies. | Përgatitet paketa udhëzuese për trajnimin e mësuesve. Trajtohen mësuesit e gjuhëve të huaja për përdorimin e platformave online në procesin e mësimit - nxënies për zhvillimin e lëndës. | Materiali i përgatitur dhe 500 mësues të trajnuar. | Vjetore | Ludmilla Stefani dhe grupi i punës |

| | | | | | | | | |
|------------|--|-------|---|---|--|----------|--|--|
| | në mësimdhënie. | | | | | | | |
| 2.6 | Të ngrihen kapacitetet e koordinatorëve të DRAP-ve, të ZVAP-ve, të shkollave dhe mësuesve që zbatojnë edukimin për artet dhe zejet në shkollë. | 2.6.1 | Ngrihen kapacitetet e koordinatorëve të DRAP-ve, të ZVAP-ve, të shkollave dhe mësuesve që zbatojnë edukimin për artet dhe zejet në shkollë. | Ngritja e kapaciteteve të koordinatorëve për zbatimin sa më cilësor dhe efektiv të programit “Edukimin për artet dhe zejet në shkollë”. | 200 koordinator të trajnuar | Vjetore | Albana Markja, Evis Mastoi dhe grupi i punës | |
| 2.7 | Të zhvillojë kapacitetet e mësuesve të TIK lidhur me zbatimin e programeve në klasë të parë. | 2.7.1 | Realizimi i trajnimeve me mësuesit e TIK të klasës së parë. | Ngrihen kapacitetet e mësuesve të TIK për zbatimin e programit të klasës së parë. | 300 mësues të TIK të trajnuar për klasën e parë. | 9-mujore | Eriksen Mersinllari dhe grupi i punës | |
| 2.8 | Të ngrihen kapacitetet e | 2.8.1 | Ngrihen kapacitetet e mësuesve të shkollave pilot që zbatojnë | Ngritja e kapaciteteve të mësuesve të shkollave pilot | 200 mësues të trajnuar. | Vjetore | Astrit Dautaj, | |

| | | | | | | | | |
|-------------|---|--------|--|---|--|----------|---|--|
| | mësuesve për programin “Edukimi për median dhe informimin”. | | programin “Edukimi për median dhe informimin”. | për zbatimin sa më cilësor dhe efektiv të programit “Edukimi për median dhe informimin”. | | | Rozeta Hyseni, Elisabeta Paja, Eriksen Mersinllari, Mimoza Milo, Ludmilla Stefani | |
| 2.9 | Të fuqizojnë rrjetet profesionale të mësuesve të klasave kolektive. | 2.9.1 | Realizimi i trajnimeve me drejtuesit e rrjeteve të klasave kolektive. | Ngrihen kapacitetet e drejtuesve të rrjeteve të klasave kolektive për zbatimin e kurrikulës me kompetenca. | 100 drejtues të rrjeteve të klasave kolektive. | 9-mujore | Erida Koleci dhe grupi i punës | |
| 2.10 | Të mbështesë drejtuesit e rrjeteve profesionale të dhe drejtuesit e | 2.10.1 | Hartimi i udhëzuesit për zbatimin e kurrikulës me kompetenca në arsimin parashkollor | Hartohet material mbështetës për mësuesit lidhur me zbatimin e kurrikulës me kompetenca në arsimin parashkollor | Udhëzuesi i përgatitur dhe i publikuar | Vjetore | Aurela Zisi | |

| | | | | | | | | |
|-------------|---|------------|---|--|---|---------|-------------|--|
| | kopshteve në arsimin parashkollor. | 2.10. 2 | Realizimi i trajnimeve me drejtuesit e rrjeteve dhe drejtuesit e kopshteve të arsimit parashkollor. | Ngrihen kapacitetet e drejtuesve të rrjeteve dhe drejtuesit e kopshteve të arsimit parashkollor lidhur me zbatimin e dokumenteve kurrikulare dhe standardeve profesionale të drejtuesve të institucioneve të arsimit parashkollor. | 500 drejtues të rrjeteve dhe drejtues të kopshteve në arsimin parashkollor. | Vjetore | | |
| 2.11 | Të mbështesë drejtuesit e rrjeteve profesionale në arsimin fillor për përdorimin e TIK në mësimdhënie – nxënie. | 2.11. 1 | Realizimi i trajnimeve me drejtuesit e rrjeteve profesionale të arsimit fillor për përdorimin e TIK në procesin e mësimdhënie – nxënie. | Ngrihen kapacitetet e drejtuesve të rrjeteve profesionale të arsimit fillor për përfshirjen e teknologjisë dhe platformave në procesin mësimor. | 500 drejtues të rrjeteve në AF të trajnuar. | Vjetore | Edlira Sina | |
| 2.12 | Të monitorohen mësuesit e certifikuar për | 2.12. 1 | Realizimi i monitorimeve me mësuesit e certifikuar për zbatimin e programit të edukimit shëndetësor seksual. | Monitorohen gjatë zhvillimit të mësimin mësuesit e trajnuar dhe certifikuar për zbatimin e | 100 mësues të monitoruar. | Vjetore | Edlira Sina | |

| | | | | | | | | |
|-------------|--|--------|--|---|------------------------------------|---------|---|--|
| | zbatimin e programit të edukimit shëndetësor seksual. | | | programit të edukimit shëndetësor seksual. | | | | |
| 2.13 | Të mbështeten rrjetet profesionale gjuhës shqipe, matematikës dhe shkencave, në përputhje me aftësitë që kërkohen në testet ndërkombëtare. | 2.13.1 | Hartimi i materialeve të trajnimit dhe modulet e trajnimit. | Hartimi i materialeve ndihmëse dhe module të trajnimit për mësuesit në lidhje me zhvillimin te nxënësit të aftësive të lexim-shkrimit, të aftësive matematikore dhe të shkencave. | 3 module trajnimit të hartuara. | Vjetore | Erida Koleci, Mimoza Milo, Elisabeta Paja, Dorina Rapti | |
| | | 2.13.2 | Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale të lëndëve gjuhë shqipe, matematikë dhe shkenca. | Trajnimi lidhet me zhvillimin te nxënësit të aftësive të lexim-shkrimit, të aftësive matematikore dhe të shkencave. | 300 drejtues rrjetesh të trajnuar. | Vjetore | | |
| 2.14 | Të mbështeten drejtuesit e rrjeteve profesionale të | 2.14.1 | Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve profesionale të lëndëve të shkencave shoqërore (histori, gjeografi, edukim qytetar). | Trajnimi bazohet në: Botimin me katër vëllime mbi adresimin e antisemitizmit në shkolla, të hartuara nga UNESCO dhe ODIHR për | 200 drejtues rrjetesh të trajnuar. | Vjetore | Ines Todhe, dhe grupi i punës | |

| | | | | | | | | |
|-------------|--|--------|--|---|--|---------|------------------------------------|--|
| | shkencave shoqërore lidhur me mënyrën se si të trajtojnë në klasë çështje që kanë të bëjnë me antisemitizmin, Holokaustin, gjenocidin, dhunën, diskriminimin apo çfarëdolloj forme tjetër të shkeljes së të drejtave të njeriut. | | | (1) mësuesit e shkollave fillore, (2) mësuesit e shkollave të mesme, (3) mësuesit e shkollave profesionale, (4) drejtorët e shkollave. Përkthimin dhe botimin në gjuhën shqipe të këtyre botimeve. | | | | |
| 2.15 | Të organizojë të gjitha veprimtaritë e TALIS 2024. | 2.15.1 | Organizohen veprimtaritë e TALIS 2024. | TALIS 2024 është studim ndërkombëtar i OECD lidhur zhvillimin profesional të drejtuesve dhe mësuesve. | Realizimi i fazës së pilotimit për TALIS 2024. | Vjetore | Dorina Rapti, Eriksen Mersinllari, | |

| | | | | | | | | |
|-------------|--|--------|--|--|---|---------|--|--|
| | | | | | | | Albana Markja, Erida Koleci, Elisabeta Paja, Ludmilla Stefani | |
| 2.16 | Të koordinojë dhe të organizojë procesin e regjistrimit të mësuesve të gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë. | 2.7.1 | Përgatitja e njoftimeve, afati i aplikimeve, përgatitja e regjistrit. | Përgatitet njoftimi dhe caktohet afati i aplikimeve. Shqyrtohen aplikimet, vlefshmëria dhe përgatitet regjistri. | Regjistri i dërguar në MASR për miratim. | Vjetore | Miranda Kurti, grupi i punës | |
| 2.17 | Të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve arsimore për | 2.17.1 | Organizohen veprimtari për zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve arsimore për menaxhimin e emergjencave. | Organizohen veprimtari për zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve arsimore për menaxhimin e emergjencave. | Veprimtaritë për menaxhimin e emergjencave. | Vjetore | Evis Mastori, grupi i punës | |

| | | | | | | | | |
|--|---|-------|---|---|---|---------|---|--|
| | menaxhimin e emergjencave. | | | | | | | |
| Objektivi i përgjithshëm 3: Të nxisë arsimin gjithëpërfshirës dhe të sigurojë mirëqenien sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve në sistemin e arsimit parauniversitar | | | | | | | | |
| 3.1 | Të ngrihen kapacitetet e mësuesve ndihmës për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta. | 3.1.1 | Fuqizimi i rrjeteve profesionale të mësuesve në ndihmës në institucionet e arsimit parauniversitar. | Organizimi i trajnimit të 61 drejtuesve të rrjeteve të mësuesve ndihmës. | Të paktën 61 drejtues rrjetesh të mësuesve ndihmës. | Vjetore | Albana Markja | |
| 3.2 | Trajnimi i mësuesve ndihmës që punojnë me nxënës me aftësi të ndryshe dhe me nxënës që nuk dëgjojnë | 3.2.1 | Ngritja e kapaciteteve të mësuesve ndihmës që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë. | Organizimi i trajnimit të mësuesve ndihmës që punojnë me nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë. | Të paktën 100 mësues ndihmës të trajnuar. | Vjetore | Erida Koleci Esion Zgjana dhe grupi i punës | |

| | | | | | | | | |
|------------|---|-------|---|---|--|-----------------|-----------------|--|
| | dhe nuk shikojnë. | | | | | | | |
| 3.3 | Të ngrihen kapacitetet e punonjësve të shërbimit psiko-social dhe oficerëve të sigurisë lidhur me veçoritë e moshës dhe fuqizimi i rrjeteve profesionale të punonjësve të shërbimit psiko – social. | 3.3.1 | Hartimi i materialeve ndihmëse për prindër dhe nxënës për ekstremizmin e dhunshëm. | Hartimi i broshurave informuese për prindër dhe nxënës në kuadër të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm. | 500 broshura për prindër 1500 për nxënës. | 9-mujor 2022 | Esion Zgjana | |
| | | 3.3.2 | Përmirësimi i dokumentacionit dhe formave të raportimit për oficerët e sigurisë në shkolla. | Rishikimi i dokumentacionit të punës së oficerëve të sigurisë në shkolla dhe përmirësimi i formateve të raportimit. | Formatet e raportimit të rishikuara (raporti i incidentit, raporti javor, raporti vjetor, meme, plani vjetor.) | 9-mujor 2022 | | |
| | | 3.3.3 | Hartimi i materialeve ndihmëse për punën e oficerëve të sigurisë. | Hartimi i materialeve që përmirësojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga oficerët e sigurisë. | Manual mbi ndihmën e parë psikologjike. | 9 - mujor | | |

| | | | | | | | |
|--|-------|--|---|---|------------|--|--|
| | 3.3.4 | Trajnimi i oficerëve të sigurisë mbi ndihmën e parë psikologjike. | Trajnimi i oficerëve të sigurisë mbi reagimin dhe përballimin ndaj fatkeqësive natyrore. | 150 oficerë sigurie të trajnuar. | Vjetore | | |
| | 3.3.5 | Hartimi i raportit të oficerëve të sigurisë për vitin shkollor 2021-2022. | Hartimi i raportit mbi ecurinë e punës së oficerëve të sigurisë bazuar tek faktet e nxjerra nga konstatimet e tyre. | Raport | 9 - mujour | | |
| | 3.3.6 | Hartimi i materialeve ndihmëse për punën e shërbimit psiko-social. | Hartimi i materialeve që mbështesin dokumentimin e punës së shërbimit psiko-social. | Manual mbi përmirësimin e funksionimit të shërbimit psiko-social. | Vjetore | | |
| | 3.3.7 | Rritja e kapaciteteve të drejtuesve të rrjeteve të shërbimit psiko-social. | Trajnimi i drejtuesve të rrjeteve të shërbimit psiko-social rreth dokumentacionit mbështetës për funksionimin e tyre. | 55 drejtues rrjetesh të trajnuar. | Vjetore | | |

| | | | | | | | |
|------------|--|-------|---|---|-------------------------------------|----------|--|
| 3.4 | Organizimi i seminarit të përvitshëm mbi programin e integruar të mësimin shqip në Diasporë. | 3.4.1 | Mbështetja e organizimit me palën e Kosovës. | Hartimi i veprimtarive të përbashkëta. | Agjenda, zhvillimi i seminarit. | 9-mujore | Erida Koleci, Esion Zgjana Grupi i punës |
| | | 3.4.2 | Hartohet një material ndihmës për mësuesit e diasporës me praktika pozitive të mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë. | Hartohet një material ndihmës për mësuesit e diasporës me praktika pozitive të mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë. | Materiali i gatshëm për në seminar. | 9-mujore | |
| 3.5 | Redaktime letrare. | 3.5.1 | Realizohen redaktimet letrare të materialeve të hartuara nga ASCAP. | Realizohen redaktimet letrare të materialeve të hartuara nga ASCAP. | Materiale të redaktuara. | Vjetore | Elfrida Begaj, Rozeta Hyseni |

III. DREJTORIA E PERFORMANCËS

Hyrje

Drejtorja e Performancës (DP) është një strukturë që funksionon në kuadër të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). Llogaridhënia e aktorëve të sistemit para publikut për nivelin e sistemit arsimor parauniversitar në raport me objektivat e vendosura dhe ndërtimi i politikave të reja për përmirësimin e sistemit arsimor, janë dy qëllimet kryesore të vlerësimit të performancës së sistemit.

DP do të grumbullojë të dhënat mbi ecurinë e treguesve të Strategjisë Kombëtare të Arsimit, të dhëna për gjithëpërfshirjen në arsim dhe zotërimin e kompetencave të të nxënësve, që reflektohet në rezultatet e nxënësve në vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, të dhëna për procesin e zhvillimit profesional të mësuesve, të dhëna për procesin e digjitalizimit të arsimit dhe të dhëna për mënyrën e funksionimit të institucioneve të arsimit parauniversitar.

Mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga raportet zyrtare dhe monitorimit të drejtpërdrejtë, DP do të hartojë raportin e vlerësimit për performancën e sistemit si dhe raporte për mënyrën e funksionimit të institucioneve. Bazuar në analizën e të dhënave DP do të bëjë propozimet përkatëse për hartimin e politikave në funksion të garantimit të performancës së sistemit. Informacioni i saktë dhe kapaciteti i duhur për ta përdorur atë, do të krijojë kushte që Ministria përgjegjëse për arsimin nëpërmjet strukturave qendrore, rajonale e vendore të saj, si dhe institucioneve arsimore, të jetë në gjendje të realizojnë qëllimin e politikave të hartuara për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit arsimor.

Shpërndarja e roleve dhe përgjegjësi për vlerësimin e hallkave të sistemit arsimor parauniversitar nuk është gjithmonë e qartë. Në këtë kuptim do të bëhet kujdes që të mos ketë mbivendosje funksionesh dhe as vakum institucional gjatë ushtrimit të përgjegjësi të këtyre institucioneve në funksion të garantimit të performancës së sistemit arsimor.

Raportet vjetore të institucioneve qendrore, rajonale dhe vendore mbi cilësinë e shërbimit arsimor do të jenë të integruara në mënyrë të tillë që të kontribuojnë në vlerësimin dhe garantimin e performancës së sistemit në nivel kombëtar.

3.1. Vizioni

Vizioni i DP është garantimi i performancës së sistemit arsimor parauniversitar me qendër nxënësin, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe konsolidimit e mëtejshëm shoqërisë shqiptare.

3.2. Qëllimi

Për përmbushjen e vizionit të saj, Drejtoria e Përfundimit ka si qëllim kryesor vlerësimin e performancës së sistemit arsimor parauniversitar, si dhe vlerësimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të institucioneve të arsimit parauniversitar në Shqipëri.

3.3. Vlerësimi i sistemit

Vlerësimi i sistemit është përdorimi i mjeteve të shumëfishta për të zhvilluar një pamje të përgjithshme të performancës arsimore. Kjo gjë e pajis publikun me informacionin e nevojshëm se si po performon sistemi i arsimit, si formë llogaridhënie dhe i pajis hartuesit e politikave me njohuri të duhur për të ndikuar vendimmarrjet politike.

Fusha e veprimit në procesin e vlerësimit të performancës së sistemit përfshin:

Së pari, vlerësimin e nivelit të realizimit të veprimtarive në kuadër të politikave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit - SKA.

Procesi vlerëson performancën e sistemit arsimor parauniversitar në raport me objektivat e vendosura për realizimin e qëllimit të politikëve në fushën e arsimit parauniversitar në kontekstin e zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi.

Së dyti, vlerësimi i mënyrës së organizimit e të funksionimit të sistemit arsimor parauniversitar.

